



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

---

Në bazë të nenit 328 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, Ministria e Drejtësisë, shpall:

**KONKURS**  
**PËR EMËRIMIN E PËRMBARUESVE PRIVAT PËR TERRITORIN E**  
**GJYKATAVE THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Të drejtë konkurimi për emërimin e përmbartuesit privat ka kandidati/ja që i plotëson kushtet ligjore si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar, dhe duhet të jetë i aftë në aspektin shëndetësor;
- të jetë jurist i diplomuar në fakultetin juridik, apo të ndonjë fakulteti juridik të ndonjë vendi tjetër, pas nostrifikimit të diplomës në Republikën e Kosovës;
- të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune juridike;
- të ketë dhënë provimin për përmbartues;
- që kundër tij nuk zhvillohet procedurë hetimore për veprë penale, përkatësisht që nuk është i dënuar për veprë penale me dënim me burg e cila veprë është e dënueshme më së paku gjashtë (6) muaj, apo për veprë penale e cila e bënë të padenjë në ushtrimin e punës së përmbartuesit privat;
- të paraqes deklaratë të noterit për gjendjen e tij materiale, me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës së rrejshme.

Konkursi shpallet për territorin e secilës Gjykatë themelore të Republikës së Kosovës, si në vijim:

- Në territorin e Gjykatës themelore në Prishtinë 2 (dy) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Mitrovicë 4 (katër) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Pejë 3 (tre) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Prizren 7 (shtatë) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Gjiilan 2 (dy) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Ferizaj 4 (katër) përmbartues privat;
- Në territorin e Gjykatës themelore në Gjakovë 6 (gjashtë) përmbartues privat.

Kandidati/ja duhet të caktojë territorin e Gjykatës themelore në të cilën konkuron.

Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes së konkursit. Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Ministrinë e Drejtësisë adresa “Ish-Ndërtesa e Rilindjes”, kati i 8-të, Zyra 812, Prishtinë.

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 67 096, çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.**